



**Oda e Stomatologëve të Kosovës**  
**Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo**

---

Kuvendi i Odës së Stomatologëve të Kosovës, në bazë të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë (Ligji Nr. 04/L-150), Neni 9 mbi Kompetencat Publike të Odave, në mbledhjen e mbajtur me 30.05.2015, miraton këtë:

**KOD ETIK**  
**PËR**  
**DOKTORËT E STOMATOLOGJISË**

**Betim**

Për çdo doktor të stomatologjisë vlen betimi në vijim:

“Me pranimin tim në profesionin mjekësor stomatolog, betohem se do të vendos jetën time në shërbim të njerëzimit.

Do të ushtroj profesionin tim me ndërgjegjshmëri e dinjitet.

Ruajtja dhe rivendosja e shëndetit të pacientëve të mi do të jetë detyra më e lartë e veprimit tim.

Do të ruaj të gjitha fshehtësitë që më janë besuar edhe mbi vdekjen e pacientit.

Do të ruaj me të gjitha forcat e mia nderin dhe dorëzimin fisnik të profesionit mjekësor - stomatolog dhe nuk do të bëj dallime gjatë ushtrimit të detyrimeve të mia mjekësore as në bazë të handicapëve përkatëse e as sipas religjionit, kombësisë, racës e as sipas përkatësisë partiake apo pozitës sociale.

Çdo jete njerëzore do t’i shërbej.

Do të ruaj, të kultivoj dhe të respektoj përgjegjësitë e anëtarit të Odës.

## **I.Kodi**

### **Neni 1**

Kodi Etik i vendosur në bazë të ligjeve, sipas të cilave punon dhe drejtohet Oda, si dhe ligjeve të tjera, në të cilat duhet të bazohet, paraqet bindjen e doktorëve të stomatologjisë lidhur me sjelljen e doktorëve të stomatologjisë ndaj pacientëve, kolegëve, partnerëve të tjerë në shëndetësi, si dhe lidhur me sjelljen e tyre në publik. Me Kodin e Etikës stomatologjike dhe deontologjisë përcaktohen parimet bazë dhe rregullat e sjelljes, të cilave duhet t'u përmbahen doktorët e stomatologjisë gjatë kryerjes së profesionit të tyre të stomatologjisë, në mënyrë që të mbrohet dinjiteti i profesionit.

Kodi Etik i shërben synimit:

- 1.1. Ruajtja dhe përkrahja e besimit ndërmjet doktorëve të stomatologjisë dhe pacientëve;
- 1.2. Sigurimi i cilësisë së veprimtarisë stomatologjike në interes të shëndetit të popullsisë;
- 1.3. Ruajtja e lirisë dhe respektit të profesionit;
- 1.4. Përkrahja e sjelljes së denjë profesionale dhe parandalimi i sjelljes së padenjë profesionale;
- 1.5. Ruajtja e nderit dhe autoritetit të Odës Stomatologjike.

## **I. Detyrat e doktorëve të stomatologjisë**

### **Neni 2**

Doktorët e stomatologjisë i shërbejnë shëndetit të çdo njeriu të popullsisë. Profesionit stomatologjik nuk është tregti. Sipas natyrës është profesion i lirë.

### **Neni 3**

Detyrë e doktorëve të stomatologjisë është të ruajnë jetën, të mbrojnë e rivendosin shëndetin, të lehtësojnë dhimbjet, t'u japin ndihmë atyre që janë duke vdekur dhe të bashkë ndikojnë në ruajtjen e bazave të natyrshme jetësore në aspektin e kuptimit të tyre për shëndetin e njeriut.

### **Neni 4**

Ushtrimi i profesionit të doktor[it të stomatologjisë kërkon kualifikimin e nevojshëm profesional. Doktorët e stomatologjisë ushtrojnë profesionin e tyre sipas ndërgjegjes së tyre, sipas rregullave të etikës stomatologjike, humanitetit dhe përgjegjësive të Odës së Stomatologëve të Kosovës. Veprimin e tyre profesional, doktorët e stomatologjisë duhet ta orientojnë në mirëqenien e pacientëve dhe nuk guxojnë të njohin e as të respektojnë parime, rregullore e udhëzime, që nuk përputhen me detyrën e tyre. Ata nuk guxojnë të vendosin interesat e personave të tretë mbi mirëqenien e pacientëve.

### **Neni 5**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar:

- 5.1. Të ofrojë shërbim shëndetësor, duke respektuar dinjitetin njerëzor;

5.2. Të respektojë të drejtat e pacientit, kolegëve dhe punëtorëve shëndetësorë;

5.3. Të respektojë rregullat e institucioneve shëndetësore;

5.4. T'i përmbahet legjislacionit dhe detyrimeve që rrjedhin nga këto ligje;

5.5. Të bashkëpunojë, të zbulojë, të lajmëroj ose me metoda të tjera të pengojë punën e personave, që aktivitetin stomatologjik e kryejnë në mënyrë joprofesionale ose në kundërshtim me ligjin.

#### **Neni 6**

Doktorit të stomatologjisë , përveç ushtrimit të profesionit të stomatologut, nuk i ndalohet ushtrimi i ndonjë veprimtarie tjetër, që përputhet me parimet etike të profesionit të stomatologut. Doktorit të stomatologjisë i ndalohet shfrytëzimi i emërimit mjekësor profesional në mënyrë të padrejtë apo për qëllime tregtare, dhe nuk guxon ta përdorë titullin, të cilin nuk e ka fituar me ligje përkatëse.

#### **Neni 7**

Doktori i stomatologjisë nuk guxon të shfrytëzojë ose të marrë shpërblim për reklamimin e produkteve dhe pajisjeve stomatologjike. Doktorët e stomatologjisë duhet të njoftojnë organet kompetente për barna lidhur me efektet e padëshiruara të mësuara nga veprimtaria stomatologjike.

#### **Neni 8**

Doktori i stomatologjisë është i detyruar që të ketë edukim të vazhdueshëm profesional dhe në punën e tij të përditshme të përdorë vetëm metodat me bazë shkencore. Doktorit të stomatologjisë është i detyruar që njohurinë e tij ta bartë te kolegët dhe punëtorët e tjerë shëndetësorë.

#### **Neni 9**

Doktorët e stomatologjisë janë të detyruar të marrin pjesë në masat e aplikuara nga Oda e Stomatologëve për sigurimin e cilësisë së veprimtarisë stomatologjike dhe të bëjnë lidhur me këtë informimin e nevojshëm të Odës së Stomatologëve.

#### **Neni 10**

### **II. Marrëdhënia doktor i stomatologjisë – pacient**

Doktori i stomatologjisë shërbimet do t'ua ofrojë të gjithëve, pa marrë parasysh moshën, gjininë, racën, nacionalitetin, bindjen fetare ose politike, pozitën shoqërore, duke respektuar njëkohësisht të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e personit, si dhe duke pasur në konsideratë interesat e pacientit si një gjë e padiskutueshme.

#### **Neni 11**

Çdo trajtim medicinal duhet të bëhet nën ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe respektimin e personalitetit, të vullnetit dhe të drejtave të pacientëve, sidomos të së drejtës së vetëvendosjes. E drejta e pacientëve për refuzimin e masave të kontrollit e trajtimit duhet respektuar. Doktorët e stomatologjisë duhet t'u përkushtojnë pacientëve vëmendje të merituar dhe të menaxhojnë në mënyrë korrekte e profesionale me kritikën dhe pakënaqësitë e pacientit.

## **Neni 12**

Doktorët e stomatologjisë respektojnë të drejtën e pacientëve për të zgjedhur ose ndërruar mjekun e tyre. Në anën tjetër – me përjashtim të detyrimeve të veçanta juridike – edhe doktorët e stomatologjisë kanë të drejtë të refuzojnë një trajtim. Dëshirën e arsyetuar të pacientit për të përfshirë një doktor të stomatologjisë shtesë apo për t’u transferuar te një doktor i stomatologjisë tjetër, doktorët e stomatologjisë trajtues sipas rregullit nuk duhet ta refuzojnë.

## **Neni 13**

Të afërmit e pacientëve dhe persona të tjerë guxojnë të jenë të pranishëm gjatë kontrollit e trajtimit, nëse doktorët e stomatologjisë përgjegjës dhe pacienti japin pëlqimin e tyre.

## **Neni 14**

Gjatë transferimit të pacientëve te kolegët apo institucione të tjera mjekësore, doktorët e stomatologjisë duhet të përcjellin me kohë përfundimet e nxjerra dhe të informojnë mbi trajtimin e deritanishëm, përderisa ekziston apo presupozohet pëlqimi i pacientit. Kjo vlen sidomos te transferimet në apo lëshime nga spitali. Dokumentet origjinale duhet të kthehen.

## **Neni 15**

Doktorët e stomatologjisë nuk guxojnë të keqpërdorin dokumentacionin e pacientëve në favor të vetin.

## **Neni 16**

Komunikimi i mirë është thelbësor në marrëdhëniet doktor i stomatologjisë - pacient. Doktor i stomatologjisë duhet t’ia mundësojë pacientit ose përfaqësuesit ligjor të pacientit që të marrë informatat rreth trajtimit të tij. Doktor i stomatologjisë duhet të sjellë informata rreth trajtimit të propozuar, opsioneve të tjera të trajtimit, rreziqet e mundshme, gjithashtu edhe çmimin, në mënyrë që t’ia mundësojë pacientit të bëjë një zgjedhje të duhur.

## **Neni 17**

Doktorëve të stomatologjisë për trajtim të pacientit u duhet pëlqimi i pacientit (në raste të veçanta , me shkrim). Sqarimet e nevojshme në lidhje me trajtimin bëhen në mënyrë private.

## **Neni 18**

Doktori i stomatologjisë në mënyrë të përshtatshme do të informojë pacientin për rezultate të analizave, si dhe për të gjitha mundësitë e shërimit dhe prognozën e tyre, si dhe të japë informata, në mënyrë që pacienti të ketë mundësi për zgjedhje adekuate të shërimit. Në rast të personave të moshës së mitur, të cilët nuk mund të marrin vendime personale, doktori i stomatologjisë duhet t’u drejtohet prindërve apo personave kujdestarë. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet konsultuar me kolegët e tjerë për vendime të mëtutjeshme.

## **Neni 19**

Doktori i stomatologjisë duhet t'u nënshtrohet parimeve kryesore të konfidencialitetit të kujdesit shëndetësor, e që janë:

19.1. Pacientët kanë të drejtën fundamentale të privatësisë dhe konfidencialitetit të informatave të tyre mbi shëndetin;

19.2. Pacientët kanë të drejtë të vendosin për të treguar ose jo për informatat e tyre mbi shëndetin e tyre, duke dhënë, mbajtur ose tërhequr pëlqimin mbi këto informata.

### **Neni 20**

Doktori i stomatologjisë duhet të sigurohet që të mbajë të dhëna/shënime të duhura (si dhe të dhënat e regjistruara në mënyrë elektronike ) shëndetësore-dentare, dhe që stafi dentar të jetë në dijeni për obligimin e tyre që ta ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të pacientit. Të dhënat duhet të merren dhe të procedohen në mënyrë të drejtë për qëllime të specifikuar, eksplicite dhe legjitime, gjithmonë sipas parimeve të mbrojtjes së të dhënave.

### **Neni 21**

Doktori i stomatologjisë mund të transmetojë të dhëna tek pala e tretë, vetëm atëherë kur lejohet me pëlqimin e pacientit, përveç në rastet kur kërkohet nga obligimet dhe detyrimet ligjore. Shënimet duhet të mbahen për të gjitha të dhënat e transmetuara tek pala e tretë.

### **Neni 22**

Doktori i stomatologjisë duhet të bëjë gjithçka që është e mundur për t'ia mundësuar pacientit që të ketë pritshmëri reale lidhur me rezultatet e tretmanit. Informatat e pavërtetuara, që ngjallin shpresë të rrejshme te pacientët dhe familjarët e tij, konsiderohen shkelje e etikës profesionale.

### **Neni 23**

Doktori i stomatologjisë duhet t'i marrë vetëm ato raste, për të cilat është kompetent, dhe duhet t'i tregojë pacientit nëse një trajtim i caktuar është kompetencë e tij.

### **Neni 24**

Doktorët e stomatologjisë duhet t'u garantojnë pacientëve me kërkesë të tyre parimisht qasje në dokumentacionin mjekësor stomatologjik, që ka të bëjë me pacientin, me përjashtim të atyre pjesëve që përmbajnë përshtypje e perceptime subjektive të stomatologut. Me kërkesë të pacientit duhet t'i jepen kopje të dokumentacionit, me gjithë mbulimin e shpenzimeve.

### **Neni 25**

Regjistrimet-shënime mjekësore stomatologjike duhet të ruhen në kohëzgjatje prej dhjetë vjetësh pas përfundimit të trajtimit, përderisa nuk ekziston një afat më i gjatë i ruajtjes sipas akteve ligjore.

### **Neni 26**

Pas punës së prekëses, doktoratë e stomatologjisë duhet të ruajnë regjistrimet mjekësore dhe të kujdesen që të kalojnë në ruajtje përgjegjëse. Doktorët e stomatologjisë, të cilëve u dorëzohen për ruajtje regjistrimet mjekësore stomatologjike mbi pacientët pas detyrës së prekëses a dorëzimit nga

praksa, duhet t'i mbajnë të mbyllura regjistrimet dhe guxojnë t'i shikojnë ose t'i përcjellin tutje, vetëm me pëlqimin e pacientes a pacientit.

#### **Neni 27**

Regjistrimet në disk apo medime të tjera të ruajtjes kanë nevojë për masa të posaçme të sigurimit dhe mbrojtjes për të mënjeluar ndryshimin, shkatërrimin apo përdorimin e paligjshëm. Doktorët e stomatologjisë duhet të kenë parasysht në këtë rast rekomandimet e Odës së Stomatologëve.

#### **Neni 28**

### **III. Honorari dhe marrëveshjet për kompensim**

Kërkesa e honorarit duhet të jetë adekuate. Për përcaktim si bazë shfrytëzohet rregullorja zyrtare e taksave, e përcaktuar nga organet e Odës Stomatologjike, për sa nuk vlejnë rregullore të tjera ligjore të kompensimit.

#### **Neni 29**

Doktorët e stomatologjisë mund të heqin dorë nga honorari tërësisht apo pjesërisht, nëse trajtojnë të afërm, kolegë, apo pacientë të varfër.

#### **Neni 30**

Para kryerjes së një shërbimi, shpenzimet e të cilit qartazi nuk mbulohen nga një sigurim shëndetësor apo nga një mbulues tjetër shpenzimesh, doktorët e stomatologjisë duhet t'i informojnë pacientët me shkrim lidhur me lartësinë e honorarit të llogaritur, sipas tarifës së Odës Stomatologjike, si dhe lidhur me atë se nuk ekziston apo nuk është e sigurt e drejta për marrjen përsipër të shpenzimeve nga ana e një sigurimi shëndetësor apo një mbuluesi tjetër shpenzimesh.

#### **Neni 31**

### **IV. Hulumtimet biomjekësore**

Hulumtimi i metodave të reja të diagnostikimit, terapisë, prevencës lejohet vetëm me lejen e Komisionit përkatës. Informatat e pavërtetuara, që ngjallin shpresë të rrejshme te pacientët dhe familjarët e tij, konsiderohen shkelje e etikës profesionale.

#### **Neni 32**

Për rezultate të arritura shkencore, doktori i stomatologjisë duhet të informojë rrethin profesional në mbledhje dhe takime shkencore, dhe pasi të ketë formuar mendim profesional, edhe publikun e gjerë.

#### **Neni 33**

Doktorët e stomatologjisë, që marrin pjesë në një iniciativë hulumtimi, në të cilën ndërhyhet në integritetin psikik e trupor të një njeriu apo shfrytëzohen materiale trupore apo të dhëna, të cilat i referohen një njeriu të caktuar duhet të sigurojnë që para zbatimit të iniciativës hulumtuese të bëhet një këshillim që synon çështjet e lidhura me të etike-profesionale e ligjore-profesionale dhe që zbatohet nga një këshill etik, i formuar në Odën Stomatologjike. Hulumtuesi ka për obligim që në periudha të caktuara kohore t'i raportojë për rezultate Këshillit Etik.

#### **Neni 34**

Në publikime të rezultateve të hulumtimit duhet të shtrohen hapur marrëdhëniet e stomatologut ndaj punëdhënësit dhe interesave të tij.

#### **Neni 35**

### **V. Marrëdhënia doktor i stomatologjisë – shoqëri**

Ushtrimi i veprimtarisë private stomatologjike duhet të bëhet në bazë të ligjit dhe udhëzimeve administrative përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe rregulloreve dhe vendimeve të Odës Stomatologjike.

#### **Neni 36**

Doktorët e stomatologjisë mund të bashkohen në shoqata për ushtrimin e profesionit, shoqata organizative, shoqata bashkëpunimi dhe lidhje praksash.

#### **Neni 37**

Doktorët e stomatologjisë guxojnë të ushtrojnë profesionin e tyre vetëm apo së bashku në të gjitha format ndërmarrëse, të lejuara për profesionin stomatologjik, nëse është garantuar dhe lejuar ushtrimi i tyre profesional me vetë përgjegjësi, në mënyrë të pavarur medicinale, si dhe në mënyrë jo tregtare. Te bashkëpunimi profesional, në çfarëdo forme qoftë, çdo doktor dhe doktoreshë e stomatologjisë duhet të garantojë se do të respektohen e përmbahen detyrimet stomatologjike.

#### **Neni 38**

Te shoqëritë për ushtrimin e profesioneve të stomatologëve duhet të komunikohen – pa lënduar emrin e një shoqërie partneriteti apo të një personi juridik të së drejtës private – emrat dhe emërtimet mjekësore të të gjithë stomatologëve të bashkuar e të përfshirë në shoqëri, si dhe forma juridike. Vazhdimi i mbajtjes së emrit të një partnereje/partneri jo më aktiv, të përjashtuar apo të vdekur është i ndaluar.

#### **Neni 39**

Doktorët e stomatologjisë duhet të ushtrojnë personalisht profesionin në praksë. Doktorët e stomatologjisë duhet të lajmërojë punësimin e bashkëpunëtorëve stomatologjikë.

#### **Neni 40**

Në rastet ku trajtimi i pacientëve zbatohet nga doktorë të stomatologjisë të fushave të ndryshme profesionale në mënyrë të përbashkët, një doktor i stomatologjisë si pronar i firmës guxon të ofrojë shërbimin stomatologjik edhe përmes një doktori të stomatologjisë profesional të punësuar.

#### **Neni 41**

Doktorët e stomatologjisë guxojnë të punësohen vetëm nën kushte të përshtatshme. Të përshtatshme janë sidomos kushtet, që i garantojnë një kompensim adekuat doktorit të stomatologjisë të punësuar,

si dhe i garantojnë kohë të përshtatshme për shkollim të mëtutjeshëm dhe që parashohin të marrëveshja e ndalesave konkurruese një shpagim të përshtatshëm kompensues.

#### **Neni 42**

Pacientët duhet të informohen lidhur me doktorët e stomatologjisë të punësuar në praksë në mënyrë adekuate.

#### **Neni 43**

Doktorët e stomatologjisë parimisht duhet të jenë të gatshëm për zëvendësim të ndërsjellë. Pacientët e marrë përsipër duhet të kthehen pas përfundimit të zëvendësimit. Doktorët e stomatologjisë parimisht guxojnë të zëvendësohen vetëm nga doktorët e stomatologjisë të fushës së njëjtë profesionale.

#### **Neni 44**

Doktorët e stomatologjisë janë të detyruar të sigurohen mjaftueshëm kundër kërkesave të bartjes së përgjegjësive, në kuadër të veprimtarisë së tyre profesionale.

#### **Neni 45**

Doktorët e stomatologjisë, në bazë të vendimeve dhe Statutit të Odës, ligjeve dhe rregulloreve të Ministrisë së Shëndetësisë, janë të detyruar të marrin pjesë në shërbimin emergjent, përkatësisht të kujdestarisë.

#### **Neni 46**

Doktorëve të stomatologjisë nuk u lejohe të kërkojnë, t'u premtohen apo të pranojnë nga pacientët apo të tjerët dhurata apo përparësi të tjera për vete apo për persona të tretë, nëse kështu lihet përshtypja se është ndikuar pavarësia e vendimit stomatologjik. Ndikimi nuk është kundër profesional atëherë, kur i shërben një mënyre trajtimi a rregullimi ekonomik mbi bazën sociale-juridike dhe kur i ruhet mundësia stomatologut të marrë vendime të ndërlidhura për arsye medicinale sesa me nxitje financiare.

#### **Neni 47**

Pranimi i përparësive të vlefshme në para në lartësi adekuate nuk është kundër profesional, përderisa këto përdoren vetëm për kualifikim profesional. Përparësia e garantuar për pjesëmarrje në një eveniment shkencor kualifikues është e papërshtatshme, nëse tejkalon shpenzimet e nevojshme të udhëtimit dhe taksat e pjesëmarrjes.

#### **Neni 48**

Pranimi i shumave nga personat e tretë për zbatimin e evenimenteve (sponsorizimi) lejohet vetëm për financimin e programit shkencor të evenimenteve kualifikuese dhe vetëm në përmasa të përshtatshme. Kushtet dhe përmasat e sponsorizimit duhet të parashtrihen haptas gjatë njoftimit dhe zbatimit të evenimentit.

#### **Neni 49**



## **VI. Marrëdhënia ndërmjet doktorëve të stomatologjisë**

Doktori i stomatologjisë duhet të insistojë në zhvillimin e marrëdhënieve të mira kolegjiale, duke u bazuar në respekt, korrektësi, sinqeritet dhe shkëmbim përvojash. Gjatë kësaj, doktori i stomatologjisë duhet të respektojë përvojën e epërëve dhe kolegëve më të vjetër, të cilët duhet të jenë shembull për kolegët e rinj.

### **Neni 50**

Doktori i stomatologjisë do të ofrojë ndihmën e tij në mënyrën më të mirë, nëse mjeku tjetër stomatolog kërkon nga ai këshillë ose ndihmë profesionale. Doktori i stomatologjisë do të përmirësojë të metat e kolegëve dhe personelit shëndetësorë në mënyrë të përshtatshme, që të mos fyhet dinjiteti i tyre.

### **Neni 51**

Doktori i stomatologjisë do të mbrojë kolegët e vet, të cilët janë fajësuar në mënyrë të pabazë, sipas rregullave të kolegjialitetit. Është i obliguar që të diskutojë me kolegë të tjerë dhe jo me pacientin, nëse ka vërejtur te ndonjë kolegj papërshtatshmëri morale, etike, ose gabim në diagnostikim apo shërim. Nëse këto parregullsi nuk korrigjohen, atëherë ai do t'u drejtohet organeve përkatëse në Odë.

### **Neni 52**

Mospajtimi në mendime profesionale nuk duhet të cenojë rregullat e sjelljes së mirë. Në rast se nuk mund të korrigjohen mospajtimit e ndërsjella, atëherë doktorët e stomatologjisë duhet të drejtohen në organet përkatëse të Odës.

### **Neni 53**

Doktori i stomatologjisë në pajtim me kompetencat e tij profesionale mund t'i ofrojë shërbim shëndetësor çdo pacienti që e kërkon këtë nga ai. Mund ta marrë nën përkujdesje pacientin e doktorit të stomatologjisë tjetër, nëse këtë e kërkon pacienti ose doktori i stomatologjisë tjetër.

### **Neni 54**

Doktori i stomatologjisë duhet të ruajë reputacionin dhe pavarësinë e tij, duke mos pranuar që emri i tij të lidhet me ndonjë aktivitet biznesor.

### **Neni 55**

Doktori i stomatologjisë duhet t'ia parashtrijë Odës së Stomatologëve të gjitha kontratat mbi veprimtarinë stomatologjike, në mënyrë që të mund të kontrollohet se a janë respektuar çështjet profesionale.

### **Neni 56**

Doktorëve të stomatologjisë nuk u lejohet të kontrollojnë a trajtojnë së bashku me persona, që nuk janë doktorë të stomatologjisë e as nuk bëjnë pjesë në bashkëpunëtorët e tyre profesional. Kjo nuk vlen për persona që gjenden në specializim për profesionin e doktorëve të stomatologjisë apo në ndonjë profesion tjetër profesional në shëndetësi.

### **Neni 57**

Bashkëpunimi me anëtarë të profesioneve të tjera shëndetësore lejohet, nëse fushat e përgjegjësisë së doktorëve të stomatologjisë dhe anëtarit të profesionit tjetër shëndetësor mbahen qartë të ndara nga njëra-tjetra.

### **Neni 58**

## **VII. Marrëdhënia e doktorit të stomatologjisë me Odën**

Doktori i stomatologjisë duhet t'i përmbushë obligimet që i ka ndaj Odës së Stomatologëve. Duhet të respektojë Statutin e Odës, Kodin Etik dhe vendimet e marra nga Oda dhe organet e komisionet e saj. Duhet të ruajë dhe rrisë reputacionin e Odës.

### **Neni 59**

Nëse doktori i stomatologjisë zgjidhet në ndonjë organ të Odës, duhet të jetë i pranishëm në seancë dhe me aktivitetin e tij të rrisë efikasitetin e punës së Odës.

### **Neni 60**

Zgjedhja e doktorit të stomatologjisë në cilindo funksion të Odës duhet të jetë nder për të.

### **Neni 61**

## **Aneksi i Kodit kryesor të Etikës**

## **VIII. Doktori i stomatologjisë dhe komunikimi elektronik**

Ky kod është një pjesë integrale e Kodit Etik për doktorët e stomatologjisë në Kosovë dhe merret me shërbimet informative dhe komunikimet elektronike në internet dhe me metodat e tjera elektronike të komunikimit. Kodi jep një guidë për komunikimin e doktorëve të stomatologjisë me doktorët e stomatologjisë të tjerë dhe konsumatorët, të cilët nuk janë anëtarë të profesionit dentar. Doktorët e stomatologjisë kanë përgjegjësi për shërbimin informues dhe për përmbajtjen e komunikimit komercial.

### **Neni 62**

## **IX. Informatat që patjetër duhet të jenë në faqe të internetit**

Një faqe internetit të shërbimeve stomatologjike duhet të shfaqë këto informata:

62.1. Emri dhe adresa gjeografike, në të cilën ndodhet ofruesi i shërbimeve;

62.2. Detajet e ofruesit të shërbimeve, duke përfshirë e-mail adresën, nr. telefonit (fax);

62.3. Titullin profesional;

62.4. Licenca dhe informata mbi regjistrimin me adresë dhe detaje të kontakteve të autoriteteve kompetente, ose një link të autoriteteve kompetente.

### **Neni 63**

#### **X. Kërkesat për informata profesionale**

Kur informatat profesionale shkarkohen në internet, stomatologët duhet të shfaqin vërtetësi, drejtësi dhe dinjitet. Dhe, kur ndërtohet një faqe e internetit, doktorët e stomatologjisë duhet të sigurojnë që përmbajtja të mos ketë informata joprofesionale, e sidomos të mos jenë tepër lavdëruese, keq informuese, apo të natyrës krahasuese. Të gjitha informatat në web faqe duhet të jenë të ndershme, objektive, lehtë të identifikueshme dhe konform cilitdo kod dhe legjislacionit vendor.

### **Neni 64**

#### **Informatat profesionale duhet t'i përfshijnë gjërat si në vijim:**

64.1. Emrin e klinikës ku doktori i stomatologjisë vepron;

64.2. Titullin profesional dhe shtetin ku është marrë ky titull;

64.3. Licenca dhe informata mbi regjistrimin me adresë dhe detaje të kontakteve të autoriteteve kompetente, ose një link të autoriteteve kompetente.

### **Neni 65**

#### **Informatat diskrete duhet të shfaqen në faqe të internetit:**

65.1. Orari i punës, nr. i telefonit;

65.2. Detajet e kujdesit emergjent që është në dispozicion në klinikë;

65.3. Detajet e shërbimit të ofruara nga doktori i stomatologjisë përgjegjës ose nga mjekët e tjerë në klinikë ose në lokacione të tjera;

65.4. Një link të shoqatës profesionale;

65.5. Linkun e web-adresës së Odës së Stomatologëve të Kosovës.

Nëse ka linqe për faqe të tjera, doktori i stomatologjisë duhet të sigurojë që ato të jenë të rëndësishme dhe që ato reflektojnë parimet e këtij kodi.

### **Neni 66**

#### **Informatat në vijim nuk duhet të vihen në faqe të internetit:**

66.1. Krahasimi i aftësive dhe kualifikimeve të asnjë mjeku stomatolog tjetër, i cili ofron shërbime stomatologjike.

## **XII. ANEX NGA LIGJI PËR ODAT E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

### **Neni 24**

#### **Këshilli Etik**

1. Këshilli i Etik:

- 1.1. Mbikëqyr zbatimin. Kodin e Etikes dhe Deontologjisë Mjekësore;
- 1.2. Merr masat e duhura ne rast të shkeljes së Kodit etik dhe te Deontologjisë mjekësore;
- 1.3. Pranon dhe shqyrton ankesat nga ana e qytetareve;

### **Neni 25**

#### **Masat Disiplinore**

1. Këshilli Etik është organ i shkalles se pare i cili fillon procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë të profesionisteve shëndetësor për shkelje te ligjit mbi odat mjekësore, statutit te odes dhe kodit te etikes mjekësore dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara shqipton këto masa disiplinore:

- 1.1. Rekomandim kolegjal;
- 1.2. Kërkon falje ndaj pacientit;
- 1.3. Qortim ose qortim publik,
- 1.4. Arsimim shtese dhe te detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;
- 1.5. Trajtimi i detyrueshëm oga alkooli, droga dhe vese te tjera;
- 1.6. Tërheqja e përkohshme ose e përhershme e licencës dhe/ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri;
- 1.7. Kompensimin e demit te pacientit kur është e përshtatshme;
- 1.8. Dënimi me te holla deri ne 3.000 euro për çdo shkelje te ligjit, detyrave profesionale dhe etike.

### **Neni 26**

1. Në procedurë para Këshillit Etik të Odës, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën administrative, në lidhje me thirrjen e palëve, sigurimin e provave, dëgjimin e palëve, përgatitjen e procesverbaleve dhe procedurat tjera.

2. Anëtari i Odës ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore doemos duhet ti mundësohet deklarimi dhe mbrojtja pranë këshillit etik.

3. Në procedure e marrjes në pyetje të anëtarëve të Odës dhe vlerësimit të provave në procedure disiplinore para këshillit etik mbahet procesverbali.

4. Sipas ankesës ndaj vendimit të këshillit etikë vendos gjyqi i nderit.